

PriBank sh.a. Raporti Vjetor 2022

PËRMBAJTJA

- | | | | |
|-----------|--|-----------|---|
| 01 | Struktura e Aksionarëve të PriBank | 02 | Vështrim i përgjithshëm |
| 03 | Departamenti i Biznesit dhe Klientëve Individual | 04 | Departamenti i Operacioneve |
| 05 | Departamenti i Financave | 06 | Departamenti i Pajtueshmërisë së Përgjithshme dhe PPP/LFT |
| 07 | Departamenti i Burimeve Njerëzore | 08 | Departamenti i Teknologjisë Informative |
| 09 | Departamenti i Auditimit të Brendshëm | 10 | Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut |
| 11 | Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare | | |

VIZIONI

Ne synojmë të jemi banka më e favorshme dhe zgjedhja e parë për klientët individual, Mikro dhe NVM.

Si bankë me staf me përvojë të gjatë në bankat vendore dhe ndërkombëtare në Kosovë, angazhimi ynë është që të krijojmë vlerë të shtuar për klientët tanë përmes shërbimeve inovative.

MISIONI

Misioni i PriBank është promovimi i ekonomisë së qëndrueshme të vendit duke ndikuar në mirëqenie më të mirë për të gjithë, nëpërmjet financimit që nxitë rritje dhe përfitim ekonomik.

PriBank është e fokusuar në klientë individualë e në veçanti në Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme, duke ofruar shërbime bankare inovative dhe të përshtatshme. Banka shton vlerën duke ofruar financime afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata në formën e kredive dhe biznesit dokumentar si një plotësues i burimeve të tjera të financimit.

MESAZHI NGA KRYETARI I BORDIT TË DREJTORËVE



Të nderuar,

Në emër të Bordit të Drejtorëve të PriBank, kam kënaqësinë t'ju drejtohem me raportin vjetor për vitin financiar të përfunduar më 31 Dhjetor 2022. Për Pribank ky ka qenë një vit i frytshëm për të arriturat dhe insistimin që të vazhdojmë të bëjmë progres drejt objektivave tona për t'u bërë një nga bankat më të çmuara në tregun e Kosovës. Si bankë e themeluar në Kosovë, më 7 Tetor 2022, ne jemi të përkushtuar t'u shërbejmë klientëve tanë me integritet dhe profesionalizëm të nivelit më të lartë.

Gjatë vitit financiar 2022, ne bëmë hapa të rëndësishëm në organizimin dhe strukturimin e bankës, që përfshijnë marrjen e licencave të nevojshme dhe hapjen e dy degëve në lokacione strategjike. Ne gjithashtu kontraktuam dhe zbatuam me sukses sistemin bazë bankar, i cili ka ndihmuar dukshëm në efikasitetin operacional dhe në përvojën e klientëve. Stafi i selisë qendrore dhe degëve, i është nënshtruar programeve rigoroze të punësimit dhe të trajnimit, duke i pajisur ata me aftësitë e nevojshme për t'u ofruar klientëve tanë shërbimin më të mirë. Si rezultat kemi pasur një fillim dhe funksionim të suksesshëm të bankës me produkte bazë - hapja e llogarive bankare për individë e subjekte tregtare, ofrimi i depozitave, kredive dhe lizingut.

Suksesi nuk do të ishte i mundur pa përkushtimin dhe mbështetjen e palëkundur të stafit tonë të përkushtuar dhe me përvojë. Ata besuan në projektin dhe projeksionet tona dhe u bashkuan në këtë iniciativë të re. Ekspertiza dhe përkushtimi i tyre kanë qenë vendimtare për të na ndihmuar të kapërcejmë sfidat dhe të arrijmë qëllimet tona të deritashme. Dëshiroj të përfitoj nga ky rast që të shpreh mirënjohje ndaj tyre dhe të ri-konfirmoj angazhimin e Bordit të Drejtorëve për t'u ofruar mjedis sa më të mirë të punës dhe mundësi për ngritje në karrierë.

Poashtu dëshiroj të shpreh mirënjohjen tonë të përzemërt për themeluesit, dhe veçanërisht për klientët tanë që na kanë besuar. Mbështetja juaj e palëkundur ka qenë e rëndësishme për të na ndihmuar të arrijmë deri këtu dhe ne mbetemi të përkushtuar që të jemi sa më efikas me produktet dhe shërbimet tona bankare.

Përderisa kemi bërë progres të dukshëm, kemi hasur edhe në sfida. Gjetja e lokacioneve të duhura për degët dhe kostot e larta të investimit për ndërtimin dhe rinovimin e zyrave për shkak të inflacionit të lartë gjatë vitit 2022 ishin një sfidë më vete. Megjithatë, dua këtu ta bëj një falenderim për menaxhmentin që ka bërë maksimumin, njëkohësisht duke e bërë të mundur që të arrijmë t'i kapërcejmë këto sfida dhe tani të shikojmë përpara për të ardhmen. E kjo është një nga hapat e rëndësishëm në rrugën tonë drejt suksesit.

Me kalimin në vitin e ardhshëm financiar, po përgatitemi për zgjerimin dhe hapjen e degëve në qytetet kryesore të Kosovës. Dhe, ky do të jetë hap themelor drejt arritjes së synimeve për të bërë Pribank-ën tonë sa më të fuqishme në tregun e Kosovës.

Këtë vit, ne kemi arritur shumë dhe kemi bërë progres të rëndësishëm në rrugën tonë drejt suksesit. Një falenderim shkon për të gjithë ata që kanë kontribuar në këto arritje dhe ju inkurajoj të bëni të njëjtën gjë edhe vitin e ardhshëm.

Faleminderit!

Sinqerisht,

Besarb Blakaj

Kryetar i Bordit të Drejtorëve

MESAZHI NGA KRYESHEFI EKZEKUTIV



Të nderuar,

Viti 2022 ishte një vit i suksesshëm për PriBank, duke qenë viti ynë i parë i funksionimit. Jemi krenarë që kemi arritur këtë sukses falë përkushtimit dhe punës së palodhur të kolegëve tanë që besuan në misionin dhe vizionin tonë. Si Kryeshef Ekzekutiv, jam i nderuar të drejtoj një ekip me kaq pasion.

Niveli i depozitave tona u rrit në 12.13 milionë euro, duke demonstruar besimin e klientëve tanë në PriBank. Ne patëm një vit të suksesshëm me 7.9 milionë euro rritje të portfolios kreditore, duke ditur se PriBank filloi me punë me datë 31 tetor 2022. Për me tepër, ne ju qasëm portofolit tonë kreditor me kujdes të shtuar, dhe duke ruajtur një nivel zero të vonesave të kredisë.

Rreziku ynë i likuiditetit menaxhohet me shumë kujdes, me një raport të ekspozimit të kredisë ndaj depozitave në 65.3 për qind. Përmirësimi i kënaqshmërisë së klientit është prioriteti ynë dhe ne kemi bërë investime të konsiderueshme në teknologji dhe trajnimin e punonjësve për t'u ofruar klientëve tanë një përvojë të jashtëzakonshme.

Ne kemi punuar shumë për të përmirësuar proceset tona, pajtueshmërinë ligjore dhe kanalet e shpërndarjes, të gjitha këto për të ruajtur një imazh pozitiv dhe real të bankës.

Ne nuk mund ta kishim arritur këtë sukses pa stafin tonë të përkushtuar, Aksionarët e PriBank, Bordin e Drejtorëve dhe, më e rëndësishmja, klientët tanë.

Ju faleminderit që na besoni dhe na mbështetni.

Sinqerisht,

Fatos Krasniqi
Kryeshef Ekzekutiv

STRUKTURA E AKSIONARËVE TË PRIBANK

Nr.	Emri dhe mbiemri i aksionarit	Numri i aksioneve	Vlera nominale	Shuma	Përqindja
1	MODEL SLOVENIA INVEST SH.P.K. (NUI 810871021)	340	10,000€	3,400,000 €	34.00%
2	KOMPANIA E SIGURIMEVE PRISIG SH.A. (NUI 810842832)	330	10,000 €	3,300,000 €	33.00%
3	MODEL SLOVENIA SH.P.K. (NUI 810029597)	330	10,000 €	3,300,000 €	33.00%
	Gjithsej	1,000	10,000 €	10,000,000 €	100.00%

Në fund të periudhës raportuese të vitit 2022, PriBank ka tre aksionarë kryesorë. Aksionari më i madh është “Model Slovenia Invest SH.P.K” i cili zotëron 34% të aksioneve në bankë, aksionari i dytë më i madh është “K.S. Prisig” SH.A me 33% të aksioneve dhe aksionari i tretë “Model Slovenia SH.P.K” që gjithashtu zotëron 33% të aksioneve në bankë.

Banka ka zbatuar një kornizë të qëndrueshme qeverisjeje që siguron që vendimet të merren në interesin më të mirë të të gjitha palëve të interesit, duke përfshirë depozituesit, huamarrësit dhe komunitetin më të gjerë. Banka zbaton gjithashtu praktikatat më të mira për të garantuar transparencë në operacionet e saj, të tilla si raportimet e rregullta dhe shpалosja e informatave për të siguruar që të gjitha palët e interesit kanë qasje në informacionet rreth operimit të bankës.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM


PriBank u fokusua në përgatitjen e një strategjie biznesi dhe planifikimin për hapjen e degëve të reja gjatë fazës së licencimit me Bankën Qendrore të Kosovës. Strategjia e bankës është e përqëndruar në shërbimin e klientëve Individualë, Mikro dhe NVM, dhe të gjitha proceset, shërbimet, dhe produktet janë të dizajnuara për të përmbushur nevojat e tyre. PriBank synon të ofrojë një gamë të gjerë shërbimesh dhe produktesh, duke u mundësuar klientëve të kryejnë shërbime bankare përmes degëve dhe kanaleve elektronike.

Që nga fillimi i saj zyrtar me 31 tetor 2022, PriBank ka ofruar produkte dhe shërbime të ndryshme bankare, duke përfshirë llogaritë rrjedhëse, llogaritë e kursimeve dhe llogari të depozitave me afat, kreditë, lizing, mbitërheqje, linjat e kredisë, garancitë bankare, transfertat kombëtare, e-banking, aplikimet online dhe një qendër të thirrjeve. Klientët mund t'i qasen këtyre shërbimeve përmes degëve dhe kanaleve elektronike, duke u dhënë atyre qasje në llogaritë e tyre 24/7. Degët e PriBank në Prishtinë dhe Ferizaj si dy degët e para, kanë qenë në dispozicion të qytetarëve për shërbime financiare, për të cilat janë kujdesur stafi profesionist me përvojë shumëvjeçare bankare.

Në tremujorin e katërt të vitit 2022 PriBank ka realizuar një portofol kreditor prej 7.9 milionë euro ose 6.63% të rritjes totale të portofolit të kredisë së sektorit bankar. Në këtë tremujor, portofoli kreditor i biznesit arriti në 5.84 milionë euro ose 8.34% të rritjes totale në raport me rritjen totale të sektorit bankar, dhe portofoli kreditor i klientëve individual prej 2.12 milionë euro ose 2.35%. Kjo rritje e portofolit kreditor është shoqëruar me një rritje solide të depozitave, duke arritur një portofol depozitash me vlerë 12.13 milionë euro në fund të vitit 2022, ose 4.6% e rritjes totale të depozitave të sektorit bankar në tremujorin e katërt të 2022 duke e bërë bankën mjaft likuide me një raport Kredi ndaj Depozitave prej 65.3%.

STRUKTURA ORGANIZATIVE

PriBank Struktura Organizative



DEPARTAMENTI I BIZNESIT DHE KLIENTËVE INDIVIDUAL

Gjatë fazës së licencimit në TM2 dhe TM3 2022, fokusi i Departamentit të Biznesit dhe atij të Klientëve Individual ishte në përgatitjen e strategjisë së biznesit, vendosjen e proceseve, shërbimeve dhe produkteve, si dhe planifikimin për hapjen e degëve të reja.

Departamenti i Biznesit luajti një rol të rëndësishëm në krijimin e strategjisë së PriBank, e cila është e fokusuar tek klientët Individual, Mikro dhe NVM-të. Të gjitha proceset, shërbimet dhe produktet janë krijuar për të përmbushur kërkesat e klientëve.

Synimi kryesor ishte të themelohet një bankë inovative që ofron shërbime dhe produkte që u mundësojnë klientëve të kryejnë shërbime bankare përmes degëve tona dhe kanaleve elektronike me lehtësi.

Departamenti i Klientëve Individual duke mbajtur në qendër të vëmendjes plotësimin e kërkesave të klientëve lansoi fushatën me mundësitë më të mira në tregun bankar për financim me kredi, pa hipotekë, produkt ky i dizajnuar me qëllim të përfshirjes së të gjitha kërkesave të klientit në një produkt të vetëm.

Spektori i Zhvillimit të Produkteve është kujdesur për dizajnimin e produkteve dhe shërbimeve bankare inovative si dhe ofrimin e shërbimit elektronik e-banking për klientët e PriBank vetëm 15 ditë pas fillimit të operimit të bankës. PriBank e-banking ju mundëson klientëve të vet qasje të shpejtë e të lehtë në platformën elektronike dhe menaxhimin e llogarive të tyre kudo dhe në çdo kohë.

Spektori i Marketingut ka mundësuar që klientët e bankës të informohen rreth bankës dhe ofertave tona përmes web-faqes e rrjeteve sociale si: Facebook, Instagram dhe LinkedIn.

Fokus i veçantë i është dhënë promovimit të ofertave unike dhe fushatave të dizajnuara me kujdes, duke qenë të pranueshme për të gjithë klientët.

Gjatë kësaj faze u themelua edhe Qendra Kontaktuese, duke u përkushtuar në pranimin e kërkesave të klientëve dhe ofrimin të zgjidhjeve. Arritje tjetër e suksesshme ishte edhe mundësimi i aplikimeve online përmes web-faqes për produktet dhe shërbimet bankare siç janë: hapja e llogarisë, aplikimi për kredi e mbiterheqje dhe shërbimi e-banking.



DEPARTAMENTI I OPERACIONEVE

Departamenti i Operacioneve është përgjegjës për operacionet ditore të bankës duke implementuar standardet e sigurisë në pajtueshmëri me të gjitha kërkesat rregullative.

Transfertat e brendshme

Departamenti i Operacioneve ka vendosur funksione bazë, duke përfshirë transfertat e brendshme, dhe është përshtatur me të gjitha kriteret dhe standardet e nevojshme për përpunimin e pagesave. Kjo ka siguruar që klientët tanë të mund të kryejnë pagesa pa probleme.

Siguria

Ofrimi i sigurisë në të gjitha transaksionet e përpunuara nga banka jonë është një prioritet kryesor për Departamentin e Operacioneve. Sistemet dhe proceset tona janë në përputhje me standardet e kërkuara nga Banka Qendrore e Kosovës. Për më tepër, ne kemi investuar në teknologjinë më moderne për të mbrojtur fondet dhe informacionin personal të klientëve tanë duke krijuar një kornizë të fuqishme të menaxhimit të rrezikut për të identifikuar dhe menaxhuar kërcënimet e mundshme të sigurisë.


Banka është e përkushtuar të ofroj shërbime bankare inovative dhe të sigurta për klientët tanë të çmuar. PriBank do të vazhdoj të investoj në Departamentin e Operacioneve për të ruajtur standardet më të larta të përsosmërisë dhe kënaqshmërisë së klientit.

DEPARTAMENTI I FINANCEVE

Departamenti i Financave është përgjegjës për menaxhimin financiar të bankës dhe për të siguruar që raportimi financiar të jetë i saktë dhe në kohë. Departamenti i Financave luan rol të rëndësishëm në mbështetjen e qëllimeve e objektivave strategjike duke siguruar që banka të operojë fuqishëm financiarisht.

Departamenti i Financave është përgjegjës për një sërë funksionesh, përfshirë planifikimin dhe analizën financiare, buxhetimin, menaxhimin e parave të gatshme dhe raportimin financiar. Ne poashtu mbikëqyrim sistemet dhe proceset e kontabilitetit të bankës, duke siguruar që ato të jenë në përputhje me standardet dhe rregulloret përkatëse të kontabilitetit.

Departamenti i Financave dhe stafi i tij profesional janë të përkushtuar për të ruajtur standardet më të larta të profesionalizmit dhe për të ofruar informacion financiar të saktë dhe në kohë për të gjithë aksionarët, menaxhmentin e lartë, bordin e drejtorëve, rregullatorin dhe auditorin e jashtëm.



DEPARTAMENTI I PAJTUESHMËRISË SË PËRGJITHSHME DHE PPP/LFT

PriBank zhvillon aktivitetet e saj në përputhje me kërkesat ligjore, rregullatore, standardet dhe praktikat më të mira në mënyrë që rritja dhe zhvillimi të bëhet në baza të shëndosha e të qëndrueshme.

PriBank, që nga fillimi i themelimit ka zbatuar funksionet e Pajtueshmërisë (Departamenti i Pajtueshmërisë së Përgjithshme dhe ai i Pajtueshmërisë për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit) dhe ka siguruar pavarësinë e tyre sipas kërkesave ligjore e rregullative.

Departamenti i Pajtueshmërisë dhe ai i PPP/LFT sipas funksioneve janë përgjegjës për të siguruar që banka të jetë në përputhje me të gjitha ligjet, rregulloret dhe udhëzimet përkatëse dhe që politikat e procedurat të rishikohen në baza të rregullta dhe të jenë efektive.

Në mbështetje për funksionet e Pajtueshmërisë, PriBank ka zbatuar masa, përfshirë këtu programe specifike trajnimi për punonjësit, vlerësime të rregullta të pajtueshmërisë dhe monitorim të vazhdueshëm të zhvillimeve rregullative. Banka gjithashtu ka zbatuar një program gjithëpërfshirës të Pajtueshmërisë me PPP/LFT që përfshin kujdesin e duhur ndaj klientit, monitorimin e vazhdueshëm të llogarive të klientëve dhe raportimin e aktiviteteve të dyshimta tek autoritetet përkatëse.

DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERËZORE

Departamenti i Burimeve Njerëzore është i një rëndësie të veçantë për PriBank. Në shërbimet financiare faktori njeri është kyç për zhvillimin e fuqizimin e mëtutjeshëm të biznesit. PriBank përmes Departamentit të Burimeve Njerëzore është kujdesur që të rekrutojë punonjës me integritet të lartë intelektual, profesional e moral.

Departamenti i Burimeve Njerëzore ka përgatitur programe trajnimi për stafin në të gjitha fazat dhe këto trajnime do i mbajmë të përditësuara duke përcjellur kërkesat e punonjësve me rritjen e bankës.

Parësore për PriBank është krijimi i një ambienti miqësor e të ngrohtë pune, ku secili staf të ndihet i respektuar duke mos toleruar diskriminimin, ngacmimin apo trajtimin jo korrekt që bie ndesh me kodin e mirësjelljes dhe legjislacionit në fuqi.



DEPARTAMENTI I TI-SË

Departamenti i TI-së i PriBank siguron e ofron zgjidhje teknologjike të nivelit më të lartë për operacionet e bankës duke garantuar sigurinë e të dhënave.

Një nga arritjet kryesore të Departamentit të TI-së ishte implementimi i suksesshëm i sistemit bazë bankar, i cili centralizon të gjitha operacionet bankare si: menaxhimi i depozitave, përpunimi i kredive dhe administrimi i informacionit të klientëve, duke rezultuar në rritjen e efikasitetit dhe saktësisë operacionale. Sistemi bazë bankar gjithashtu mundëson ofrimin e produkteve dhe shërbimeve të reja, duke përpunuar pa probleme dhe në kohë reale të gjitha transaksionet.

Arritje tjetër e rëndësishme ishte implementimi i e-banking. Departamenti i TI-së punoi ngushtë me kontraktorët e jashtëm për të siguruar integrimin e pandërprerë të e-banking me sistemet e bankës, si dhe ofroi mbështetje teknike gjatë fazës së implementimit. Kjo zgjidhje u ka ofruar klientëve lehtësi në qasjen e produkteve bankare duke reduktuar vizitat e panevojshme në degët e bankës. Në këtë mënyrë efica operacionale është përmirësuar.

Departamenti i TI-së zbatoi masa sigurie të avancuara për të mbrojtur të dhënat e bankës, duke përfshirë vendosjen e “firewalls”, sistemet e zbulimit dhe parandalimit të ndërhyrjeve dhe zgjidhje efektive të sigurisë. Këto masa parandalojnë çdo cenim të mundshëm të të dhënave dhe sigurojnë konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave të bankës.

Në përgjithësi, përpjekjet e Departamentit të TI-së kanë qenë të nevojshme për t'a bërë PriBank një institucion financiar më të përqendruar te klientët, të sigurt dhe teknologjikisht të avancuar. Arritjet e Departamentit të TI-së në vitin 2022 kanë rezultuar në rritjen e efikasitetit, përmirësimin e përvojës së klientit dhe ofrimin e sigurisë së të dhënave të ndjeshme.

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Departamenti i Auditimit të Brendshëm është i pavarur nga funksionet e tjera në PriBank dhe si i tillë i raporton Bordit të Drejtorëve përmes Komitetit të Auditimit. Objektivi i Departamentit të Auditimit të Brendshëm është monitorimi i vazhdueshëm i sistemit të kontrollit të brendshëm, duke ofruar një vlerësim të pavarur të përshtatshmërisë dhe pajtueshmërisë me politikat dhe procedurat e vendosura të PriBank si dhe me kërkesat rregullatore e kornizën ligjore në fuqi.

Procesi i auditimit të brendshëm kryhet përmes planifikimit vjetor të auditimit ku objektivat dhe afatet e përgjithshme të auditimeve gjatë një viti kalendarik përcaktohen sipas nivelit të vlerësuar të rrezikut të proceseve dhe njësive të PriBank. Plani vjetor i auditimit mund të rishikohet për të reflektuar ndryshimet në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe për të integruar linja të reja biznesi. Plani i auditimit i nënshtrohet miratimit nga Komiteti i Auditimit.

Komiteti i Auditimit të Pribank përbëhet nga tre (3) anëtarë - dy (2) anëtarë të bordit të drejtorëve dhe një (1) anëtar i jashtëm i pavarur në fushën e kontabilitetit dhe auditimit. Qëllimi kryesor i Komitetit të Auditimit është të sigurojë mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar, procesin e auditimit, sistemet e kontrollit të brendshëm të kompanisë dhe pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret në fuqi.



DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT TË RREZIKUT

Menaxhimi i rrezikut kreditor

Rreziku kreditor është një prej rreziqeve më të mëdha për PriBank, duke pasur parasysh kushtet ekonomike në Kosovë. Për këtë arsye PriBank ka vënë theksin në praktikat më të avancuara të menaxhimit të rrezikut në këtë fushë. Aktivitetet kredituese të bankës janë të përqëndruara tek klientët individual, Mikro, NVM-të , dhe banka ka zbatuar një kornizë të fuqishme të menaxhimit të rrezikut kreditor për të siguruar që aktivitetet e saj të kreditimit të kryhen në mënyrë të sigurtë dhe të shëndoshë.

Objektivi i menaxhimit të rrezikut kreditor në PriBank është arritja e cilësisë së portofolit të kredisë, minimizimi i përqëndrimit të rrezikut, sigurimi i mbulimit të duhur të kolateralit dhe sigurimi i provizioneve të mjaftueshme për humbjet nga kreditë. Banka përdor një sërë qasjesh për të menaxhuar kufirin në rrezikun kreditor dhe ka përcaktuar proceset e saj për të identifikuar kapacitetin e klientit për huamarrje dhe për të siguruar që aktivitetet e saj të kreditimit të kryhen në mënyrë të përgjegjshme.

Banka, që nga fillimi i veprimtarisë së saj, ishte në përputhje me SNRF-9 në të gjitha proceset e saj të rrezikut kreditor. PriBank bën analiza të vazhdueshme të tregut dhe vlerësime të sektorit ekonomik për të siguruar që aktivitetet e saj kredituese të bëhen duke marrë parasysh informatat më të gjera ekonomike në Kosovë. Për më tepër, banka ka një portofol kredie të menaxhuar mirë, e diversifikuar sipas gjeografisë, industrisë dhe llojit të huamarrësit.

Departamenti i Rrezikut Kreditor ka zbatuar një model të brendshëm të vlerësimit të kredisë që nga dita e parë për të lehtësuar procesin e menaxhimit të rrezikut. Ky sistem do i siguroj bankës një vlerësim të plotë dhe të saktë të aftësisë kreditore të huamarrësve të saj. Duke përdorur një metodologji të standardizuar të vlerësimit, banka vlerëson në mënyrë efikase rrezikun e kredisë që lidhet me lloje të ndryshme të kredive dhe huamarrësve. Përmes këtyre informacioneve, banka merr vendime më të shëndosha që e ndihmojnë në reduktimin e humbjeve potenciale që rrjedhin nga portofoli kreditor dhe përmirëson kualitetin e përgjithshëm të saj.

Monitorimi i klientëve është një aspekt i rëndësishëm i aktiviteteve të bankës për menaxhimin e rrezikut kreditor. Banka përdor teknika të përditësuara të analizës së rrezikut për të monitoruar klientët e saj dhe për të siguruar që çdo rrezik që shfaqet është i identifikuar dhe menaxhuar në kohën e duhur.

Menaxhimi i rrezikut nga palët

Menaxhimi i rrezikut nga palët është i rëndësishëm dhe një komponent i menaxhimit të rrezikut kreditor, rrezikut të likuiditetit dhe rrezikut operacional. Banka nuk angazhohet në investime spekulative dhe investimet e bankës janë në përputhje me apetitin e saj për rrezik dhe në përputhje me strategjinë e saj të përgjithshme të biznesit.

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit dhe financimit

PriBank pajtohet se rreziqet e likuiditetit dhe financimit janë rreziqe me rëndësi që duhet të menaxhohen në mënyrë efektive. Korniza e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit dhe financimit të bankës është krijuar për të siguruar që banka të ketë likuiditet adekuat dhe financim të qëndrueshëm për të përmbushur detyrimet e saj dhe për të mbështetur operacionet si në kushte normale ashtu edhe në kushte stresuese.

Banka është e angazhuar për të menaxhuar rreziqet e saj të likuiditetit dhe financimit në mënyrë të përgjegjshme dhe të qëndrueshme dhe ka zbatuar një sërë masash për të mbështetur këtë objektiv. Këto masa përfshijnë mbajtjen e niveleve të përshtatshme të likuiditetit dhe rezervave të financimit, diversifikimin e burimeve të financimit dhe sigurimin që financimi të jetë i disponueshëm për të mbështetur operacionet e saj në një sërë kushtesh tregu.

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit dhe financimit të bankës është i integruar ngushtë në kornizën e përgjithshme të menaxhimit të rrezikut. Departamenti i menaxhimit të rrezikut dhe stafi i njësisë së thesarit monitorojnë likuiditetin dhe pozicionin e financimit të bankës në mënyrë të vazhdueshme.

Menaxhimi i rrezikut të valutës së huaj

Rreziku i valutës së huaj është një rrezik që lind nga luhatjet e kursit të këmbimit. Për të menaxhuar këtë rrezik, banka ka krijuar një kornizë gjithëpërfshirëse të administrimit të rrezikut të valutës së huaj, i cili përfshin politika, procedura dhe kufij rreziku.

Gjatë vitit 2022, banka ka funksionuar vetëm në monedhën EURO prandaj, banka nuk ishte e ekspozuar ndaj rrezikut të valutës së huaj.

Mjaftueshmëria e Kapitalit

Mjaftueshmëria e kapitalit të bankës llogaritet në baza të rregullta dhe i raportohet Bordit të Drejtorëve dhe Menaxhmentit nëpërmjet Komitetit të Menaxhimit të Rrezikut, së bashku me parashikimet. Kjo siguron pajtueshmërinë me kërkesat rregullatore për mjaftueshmërinë e kapitalit. Menaxhimi i mjaftueshmërisë së kapitalit ndërmerret në bazë të politikave të menaxhimit të rrezikut të cilat janë në përputhje të plotë me Rregulloret e BQK-së.

Menaxhimi i Rrezikut Operacional

Menaxhimi i rrezikut operacional është një fushë e rëndësishme e fokusit për PriBank duke zbatuar një kornizë të fuqishme për të identifikuar, matur, monitoruar dhe menaxhuar risqet operationale. Korniza përfshin një sërë mjeteve dhe teknikash, të tilla si një bazë të dhënash për regjistrimin e ngjarjeve të rrezikut, treguesit kryesor të rrezikut (Key Risk indicators), vetëvlerësimin e kontrollit të rrezikut (Risk Control Self-Assessment) dhe analizën e të gjitha shërbimeve dhe proceseve të reja duke përdorur miratimin e rrezikut të produkteve të reja (New Product Risk Assessment).



RAPORTI VJETOR 2022

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe Bordin e Drejtorëve të PriBank

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të PriBank ("Banka"), që përfshinë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2022, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar në këtë datë, dhe shënimet tjera shpjeguese për pasqyrat financiare duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit. Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar të bankës më 31 dhjetor 2022, si dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për periudhën prej 4 Janar 2022 deri më 31 Dhjetor 2022 (data e inkorporimit) në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Bazat për opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Banka në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët (Kodi IESBA) dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera në Raportin Vjetor

Menaxhmenti është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacioni tjetër përfshinë informacionin e përfshirë në Raportin Vjetor të Bankës në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 04/L-093. Raporti Vjetor i Bankës pritet të na vihet në dispozicion pas datës së raportit tonë të auditimit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk do të shprehim asnjë formë konkluzioni sigurie për to. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionet tjera të identifikuar më sipër kur të bëhet i disponueshëm dhe duke e bërë këtë, të shqyrtojmë nëse informacioni tjetër është materialisht në kundërshtim me pasqyrat financiare ose njohuritë tona të marra në auditim, ose përndryshe duket të jetë i gabuar materialisht. Kur lexojmë Raportin Vjetor të Bankës, nëse konkludojmë se ka një anomali materiale në të, duhet t'ua komunikojmë këtë çështje personave të ngarkuar me qeverisjen.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Bankës për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Bankën apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativë tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë. Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- I kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes të një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Kompanisë.
- I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmentit, duke u bazuar në dëshmitë e siguruarat të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e kompanisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundim se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojë që Banka të pushojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë edhe informacione të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksione dhe ngjarje në mënyre të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e kompanisë, në mes tjerash, edhe për fushëveprimin e planifikuar dhe kohën e auditimit, si dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që identifikojmë gjatë auditimit.

Sami Tahiraga
BDO Kosova L.L.C.
Partner i Angazhimit
31 Mars, 2023
Rr. Ukshin Hoti, C 4/3, Hy.A, Kati II
Pristinë, Kosovë

Pasqyra e Pozicionit Financiar

	Shënim	Më 31 Dhjetor 2022 (në EUR)
Pasuritë		
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	7	12,402,953
Kredi dhe paradhënie për klientët	8	7,921,067
Prona dhe pajisjet	10	609,196
Pasuritë e paprekshme	9	204,750
E drejta e përdorimit të pasurisë	11	247,839
Pasuritë tjera	12	759,285
Gjithsej pasuritë		22,145,090
Detyrimet		
Detyrimet ndaj klientëve	13	12,131,478
Detyrimet për qira	14	248,951
Detyrimet tjera	15	274,440
Gjithsej detyrimet		12,654,869
Ekuiteti		
Kapitali aksionar	16	10,000,000
Humbje për vitin		(509,779)
Gjithsej Ekuiteti		9,490,221
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti		22,145,090

Këto pasqyra financiare janë autorizuar për publikim nga menaxhmenti i Pribank sha, më 31 Mars 2023.

Z. Fatos Krasniqi
Kryeshef Ekzekutiv

Z. Ardian Damoni
Zyrtar i Lartë i Financave

Pasqyra e Fitimit apo Humbjes dhe Të Ardhurave Tjera Gjithëpërfshirëse

	Shënim	Periudha nga 14 Janari 2022 deri më 31 Dhjetor 2022 (në EUR)
Të ardhura nga interesi	17	20,271
Shpenzimet e interesit	18	(6,163)
Të ardhura neto nga interesi		14,108
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet	19	1,949
Shpenzimet e tarifave dhe komisioneve	19	(3,267)
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet, neto		(1,318)
Gjithsej të ardhurat operative		12,790
Humbjet nga zhvlerësimi i pasurive financiare	8	(36,600)
Shpenzimet e personelit	20	(329,652)
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	21	(211,485)
Humbja para tatimit	22	(564,947)
Të ardhurat nga tatimi i shtyrë		55,168
Humbja për vitin		(509,779)
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse		-
Gjithsej humbja gjithpërfshirëse për vitin		(509,779)

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 25 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet

	Kapitali aksionar (në EUR)	Humbja e akumuluar (në EUR)	Gjithsej (në EUR)
Gjendja më 1 Januar 2022	-	-	-
Kontributet	10,000,000	-	10,000,000
Humbja për vitin	-	(509,779)	(509,779)
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2022	10,000,000	(509,779)	9,490,221

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 25 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Rrjedhjes së Parasë

	Shënim	Periudha nga 14 Janari 2022 deri më 31 Dhjetor 2022 (në EUR)
Rrjedhja e parasë nga aktivitetet operative		
Humbja për vitin para tatimit		(564,947)
Rregullimet:		
Amortizimi	9	3,344
Zhvlerësimi	10-11	51,735
Humbjet nga zhvlerësimi i kredive	8	36,407
Provizione për aktivet financiare	7	193
Të hyrat nga interesi	17	(20,271)
Shpenzimet e interesit	18	6,163
		(487,376)
Ndryshimet në:		
Kredi dhe paradhënie për klientët	8	(7,943,625)
Balanca e kufizuar me BQK-në	7	(122,502)
Pasuri të tjera	12	(24,117)
Detyrimet ndaj klientëve	13	12,129,020
Detyrimet tjera	15	274,440
Interesi i pranuar		6,422
Interesi i paguar		(3,705)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		3,828,557
Tatimi i paguar në të ardhura		-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative		3,828,557
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Blerjet e pronës dhe pajisjeve	10	(624,975)
Blerjet e pasurisë së paprekshme	9	(208,094)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese		(833,069)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		
Rritje në aksione		9,320,000
Detyrimet e qirasë		(34,844)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese		9,285,156
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit		12,280,644
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit		-
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	7	12,280,644

Shënimet shoqëruese nga 1 deri 25 janë pjesë përbërëse të këtyre pasqyrave financiare.

1. TË PËRGJITHSHME

PriBank SHA (“Banka”) është themeluar në Republikën e Kosovës më 14 janar 2022 si shoqëri aksionare.

Më 31 tetor 2022, PriBank është licencuar për të operuar si bankë në të gjitha aktivitetet bankare sipas rregulloreve të Bankës Qendrore të Kosovës dhe është subjekt i ligjit nr. 04/L-093 “Për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare”. Banka është bankë tregtare që ofron shërbime dhe produkte për kompanitë e vogla dhe të mesme e (NVM) si dhe për individët privatë.

Adresa e Bankës është Kalabria, rruga Sicilia, Blloku A1, Lam A1/2, Nr.2. 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës. Banka operon me dy degë të vendosura në Prishtinë dhe Ferizaj. Numri i përgjithshëm i të punësuarve në fund të vitit 2022 ishte 48.

2. BAZAT E PËRGATITJES

2.1 Bazat e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”) të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) sipas supozimit të vazhdimësisë. Politikat rëndësishme kontabël të aplikuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë.

2.2 Monedha funksionale dhe raportuese

Këto pasqyra financiare paraqiten në Euro (“EUR”), që është monedha funksionale e bankës, monedha e mjedisit primar ekonomik në të cilin banka operon.

2.3 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Në përgatitjen e pasqyrave financiare menaxhmenti ka bërë gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave të Bankës dhe në shumate raportuara të aseteve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet përkatëse rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet për vlerësimet njihen në mënyrë prospektive. Më specifikisht, informacionet mbi elemente të rëndësishme të pasigurive në vlerësim dhe gjykime kritike në zbatimin e politikave kontabël, të cilat kanë efektin më të rëndësishëm në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet 5 dhe 6.

2.4 Parimi vijimësisë

Menaxhmenti i Bankës ka bërë një vlerësim mbi aftësinë për të vazhduar me parimin e vijimësisë dhe mendon që ka burime të mjaftueshme për të vazhduar aktivitetin për të ardhmen e parashikueshme. Gjithashtu, menaxhmenti nuk është i informuar për ndonjë pasiguri materiale që mund të hedh dyshime serioze mbi aftësinë e Bankës për të vazhduar parimin e vijimësisë.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

Banka ka aplikuar në mënyrë të vazhdueshme politikat kontabël për të gjithat periudhat të paraqitura më poshtë në këto pasqyra financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja konvertohen në monedhën funksionale me kursin e datës së raportimit.

Fitimi ose humbja në monedhë të huaj për transaksionet monetare është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës dhe koston e amortizuar në monedhë të huaj të konvertuar me kursin e këmbimit në fundin e periudhës. Asetet dhe detyrimet jo-monetare të shprehura në monedhë të huaj, të cilat janë të matura me kosto historike, konvertohen me kursin e këmbimit valutor në datën e transaksionit.

3.2 Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit njihen fitim ose humbje me anë të metodës së normës efektive të interesit. Norma efektive e interesit është norma e cila bën aktualizimin e flukseve të pagesave dhe arkëtimeve të pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së pritshme të aktivitetit ose detyrimit financiar (ose sipas rastit mund të jetë një periudhë më e shkurtër) deri në shumën e mbartur të aktivitetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit përcaktohet në njohjen fillestare të aktiveve dhe detyrimeve financiare dhe mund të rishikohet në bazë të kushteve kontraktuale.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha kostot e transaksionit dhe komisionet e zbritjet e tjera të paguara ose pranuar, të cilat janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv. Kostot e transaksionit përfshijnë kostot shtesë që janë direkt të lidhura me blerjen apo lëshimin e një aktivi apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në humbje ose fitim përfshijnë interesin nga aktivitetet dhe detyrimet financiare me kostotë amortizuar mbi bazën e interesit efektiv.

3.3 Tarifat dhe komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet për tarifatat dhe komisionet të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit të një aktivi ose detyrimi financiar, përfshihen në matjen e normës efektive të interesit. Kur një zotim i kredisë nuk pritet të rezultojë në tërheqjen e një kredie, tarifatat e lidhura me zotimin e kredisë njihen në bazë lineare përgjatë periudhës së zotuar.

Të ardhurat e tjera nga tarifatat dhe komisionet njihen në momentin e kryerjes së shërbimeve.

3.4 Qiratë

Banka njih një pasuri me të drejtëpërdorimi dhe një detyrim qirajenë datën e fillimit të qirasë me përjashtim të:

- Qirave të pasurive me vlerë të ulët; dhe
- Qirave me kohëzgjatje 12 muaj ose më pak

Pasuritë me të drejtë të përdorimit maten fillimisht me shumën e detyrimit të qirasë, reduktohen për çdo stimuj qiraje të marrë dhe të rritur për:

- pagesat e qirasë të bëra në ose para fillimit të qirasë;
- kostot fillestare direkte të bëra; dhe
- shuma e çdo provizioni të njohur kur Bankës i kërkohet me kontratë për të çmontuar, hequr ose rivendosur aktivin e dhënë me qira.

Pasuritë me të drejtë të përdorimit amortizohen në bazë lineare gjatë periudhës së mbetur të qirasë ose gjatë jetës së mbetur ekonomike të pasurisë nëse, rrallë, kjo vlerësohet të jetë më e shkurtër se afati i qirasë.

Detyrimet e qirasë maten me vlerën aktuale të pagesave kontraktuale që i detyrohen qiradhënësit gjatë afatit të qirasë, me normën e skontimit të përcaktuar duke iu referuar normës së natyrshme në qira, përveç rasteve kur kjo nuk është lehtësisht e përcaktueshme, në këtë rast përdoret norma rritëse e huamarrjes së Bankës në fillimin e qirasë. Pagesat e ndryshueshme të qirasë përfshihen në matjen e detyrimit të qirasë vetëm nëse varen nga një indeks ose normë. Në raste të tilla, matja fillestare e detyrimit të qirasë supozon se elementi i ndryshueshëm do të mbetet i pandryshuar gjatë gjithë afatit të qirasë. Pagesat e tjera të ndryshueshme të qirasë shpenzohen në periudhën me të cilën ato lidhen.

Pas njohjes fillestare, detyrimet e qirasë rriten si rezultat i interesit të ngarkuar me një normë konstante mbi tepricën e mbetur dhe zvogëlohen për pagesat e qirasë të bëra. E drejta e përdorimit të pasurisë amortizohet në bazë lineare gjatë periudhës së mbetur të qirasë ose gjatë jetës së mbetur ekonomike të pasurisë nëse, rrallë, kjo vlerësohet të jetë më e shkurtër se afati i qirasë.

Kur Banka rishikon vlerësimin e saj për afatin e çdo qiraje (sepse, për shembull, ajo rivlerëson mundësinë e ushtrimit të një opsioni të zgjatjes ose përfundimit të qiramarrësit), ajo rregullon vlerën kontabël të detyrimit të qirasë për të pasqyruar pagesat që duhen bërë gjatë afatit të rishikuar, të cilat zbriten duke përdorur një normë skontimi të rishikuar. Vlera kontabël e detyrimeve të qirasë rishikohet në mënyrë të ngjashme kur rishikohet elementi variabël i pagesave të qirasë në të ardhmen që varen nga një normë ose indeks, përveç se norma e skontimit mbetet e pandryshuar. Në të dyja rastet bëhet një rregullim ekuivalent në vlerën kontabël të aktivitetit të së drejtës së përdorimit, me vlerën kontabël të rishikuar që amortizohet gjatë periudhës së mbetur (të rishikuar) të qirasë. Nëse vlera kontabël e aktivitetit të së drejtës së përdorimit rregullohet në zero, çdo reduktim i mëtejshëm njihet në fitim ose humbje.

3.5 Tatimi në fitim

Tatimi në fitim është paraparë në pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin (Tatimi në të Ardhurat e Korporatave nr. 06/L-105). Tatimi aktual mbi të ardhurat llogaritet bazuar në rregulloret e tatimit mbi të ardhurat në fuqi në Kosovë, duke përdorur normat tatimore të miratuara në datën e raportimit. Shkalla e tatimit mbi të ardhurat e korporatave është 10%.

Tatimi mbi të ardhurat përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë mbi të ardhurat dhe njihet në fitim ose humbje për vitin, përveç nëse njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ose drejtpërdrejtë në kapitalin neto, sepse lidhet me transaksione që njihen gjithashtu, në të njëjtën ose një periudhë të ndryshme, në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ose drejtpërdrejt në kapital.

Tatimi aktual

Tatimi aktual është shuma që pritet t'i paguhet ose të rikuperohet nga autoritetet tatimore në lidhje me fitimet ose humbjet e tatueshme për periudhat aktuale dhe ato të mëparshme. Fitimet ose humbjet e tatueshme bazohen në vlerësime nëse pasqyrat financiare janë të autorizuara përpara paraqitjes së deklaratave tatimore përkatëse. Taksat e tjera përveç mbi të ardhurat regjistrohen brenda shpenzimeve administrative dhe shpenzimeve të tjera operative.

Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë mbi të ardhurat sigurohet duke përdorur metodën e detyrimit të bilancit për humbjet tatimore të bartura dhe diferencat e përkohshme që lindin ndërmjet bazës tatimore të aktiveve dhe detyrimeve dhe vlerës së tyre kontabël për qëllime të raportimit financiar. Tepricat tatimore të shtyra maten me normat tatimore të miratuara ose të miratuara në mënyrë thelbësore në fund të periudhës raportuese, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të kthehen ose do të përdoren humbjet e bartura tatimore. Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme dhe humbjet tatimore të bartura regjistrohen vetëm në masën që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit mund të përdoren zbritjet.

3.6 Pasuritë dhe detyrimet financiare

Njohja

Banka fillimisht njeh kreditë dhe paradhëniet, detyrimet ndaj klientëve dhe huamarrjet në datën e krijimit të tyre. Të gjitha aktivet dhe detyrimet tjera financiare (duke përfshirë blerjet dhe shitjet e rregullta) njihen fillimisht në datën e tregtimit, që është data në të cilën Banka bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Klasifikimi dhe matja fillestare e aktiveve financiare

Të gjitha aktivet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit (aty ku është e aplikueshme).

Aktivtë financiare, të ndryshme nga ato të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse, klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:

- Kostoja e amortizuar
- Vlera e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVTPL)
- Vlera e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI).

Klasifikimi përcaktohet nga dy:

- Modelin e biznesit të njësisë ekonomike për menaxhimin e pasurisë financiare
- Karakteristikat e rrjedhës së parasë kontraktuale të pasurisë financiare.

Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me aktivet financiare njihen në fitimose humbje.

Vlerësimi i modelit të biznesit

SNRF 9 identifikon tre lloje të modeleve të biznesit: 'mbajtje për të mbledhur', 'mbajtje për të mbledhur dhe shitur' dhe 'të tjera'. Banka përcakton modelin e saj të biznesit në nivelin që pasqyron më së miri se si ajo menaxhon grupet e pasurisë financiare për të arritur objektivin e saj të biznesit. Modeli i biznesit të Bankës nuk vlerësohet në bazë instrument pas instrumenti, por në një nivel më të lartë të portfoliove të agreguara.

Mbajtje për të mbledhur

Objektivi i modelit të biznesit 'mbajtje për të mbledhur' është të mbajë pasuritë financiare për të mbledhur flukset e tyre monetare kontraktuale, në vend që të shesë pasuritë për të gjeneruar flukse monetare. Vetëm aktivet financiare që plotësojnë testin SPPI (vetëm pagesat e kryegjësë dhe interesit në borxhin e shumës së kryegjësë) dhe mbahen në një model biznesi 'mbajtje për të mbledhur' klasifikohen me kosto të amortizuar.

Mbajtje për të mbledhur dhe shitur

Sipas modelit të biznesit 'mbajtje për të mbledhur dhe shitur', objektivi është të mblidhen flukset monetare kontraktuale dhe të shiten pasuritë financiar. Në kontrast me modelin e biznesit 'mbajtje për të mbledhur', shitjet janë pjesë integrale dhe jo rastësore dhe për rrjedhojë ky model biznesi zakonisht përfshin një frekuencë dhe vëllim më të madh shitjesh.

Vetëm pasuritë financiare që plotësojnë testin SPPI dhe mbahen në një model biznesi 'mbajtje për të mbledhur dhe shitur' klasifikohen me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për borxhin.

Të tjera

Modele të tjera biznesi janë të gjitha ato që nuk plotësojnë kriteret kualifikuese 'mbajtje për të mbledhur' ose 'mbajtje për të mbledhur dhe shitur'. Pasuritë financiare brenda modeleve të biznesit për të cilat objektivi parësor është realizimi i flukseve monetare nëpërmjet shitjes, ose modelet e biznesit të cilat menaxhohen dhe vlerësohet performanca mbi bazën e vlerës së drejtë ose të mbajtura për tregtim dhe të gjitha pasuritë financiare jo të kapitalit që bien në modele "të tjera" biznesi duhet të klasifikohet me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, pavarësisht nëse ka kaluar testin SPPI.

Kreditë dhe paradhëniet për klientët

Kreditë dhe paradhëniet për klientët përbëhen nga lehtësira të ndryshme financimi si: tregti, shërbime, konsumuese, strehimi dhe prodhimi. Këto produkte janë pasuri financiare jo-derivative me pagesa fikseose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në një treg aktiv dhe që mbahen për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale të principalit dhe interesit. Vlera e drejtë e huave dhe paradhënieve për klientët nuk është një aspekt thelbësor në administrimin e portfolios së Bankës.

Modeli i biznesit i Bankës sipas SNRF 9 është "mbajtje për të mbledhur" dhe kreditë dhe paradhëniet për klientët maten me koston e amortizuar.

Klasifikimi - (periudha krahasuese)

Pasuritë financiare klasifikohen në kategorinë 'kredi dhe arkëtime'. Klasifikimi varet nga natyra dhe qëllimi i aktiveve financiare dhe përcaktohet në kohën e njohjes fillestare. Të gjitha blerjet ose shitjet në mënyrë të rregullt të pasurive financiare njihen dhe çregjistrohen në bazë të datës së tregtuar. Blerjet ose shitjet në mënyrë të rregullt janë blerje ose shitje të aktiveve financiare që kërkojnë shpërndarjen e pasurive brenda afatit kohor të përcaktuar me rregullore ose konventë në treg.

Matja pasuese e pasurive financiare

Pasuritë financiare me kosto të amortizuar

Pasuritë financiare maten me koston e amortizuar nëse aktivet plotësojnë kushtet e mëposhtme (dhe nuk përcaktohen si FVTPL):

- ato mbahen brenda një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është të mbajë pasuritë financiare dhe të mbledhë flukset e tij të kontratës
- Kushtet kontraktuale të pasurive financiare shkaktojnë flukse monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe interes mbi shumën kryesore të mbetur.

Pas njohjes fillestare, këto maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Zbritja nuk përfshihet kur efekti i zbritjes është jo-material. Paraja dhe ekuivalentët të saj, kreditë dhe shumica e arkëtimeve të tjera, hyjnë në këtë kategori instrumentesh financiare.

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes (FVTPL)

Pasuritë financiare që mbahen brenda një model biznesi të ndryshëm përveç 'mbajtjes për të mbledhur' ose 'mbajtjes për të mbledhur dhe shitur', kategorizohen në vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes. Për më tepër, pavarësisht nga pasuritë financiare të modelit të biznesit, flukset monetare kontraktuale të cilave nuk janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit llogariten në FVTPL. Të gjitha instrumentet financiare derivative hyjnë në këtë kategori, përveç atyre të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse. Kategoria gjithashtu përmban një investim në kapital. Në vitin aktual financiar, vlera e drejtë u përcaktua në përputhje me kërkesat e SNRF 9, i cili nuk lejon matjen në kosto. Pasuritë në këtë kategori maten me vlerën e drejtë me fitimet ose humbjet e njohura në pasqyrën e të ardhurave. Vlerat e drejta të aktiveve financiare në këtë kategori përcaktohen duke iu referuar transaksioneve aktive të tregut ose duke përdorur një teknikë vlerësimi kur nuk ekziston një treg aktiv. Banka përcaktoi që në periudhën aktuale vlera e drejtë e këtyre investimeve përafrohet me vlerën e tyre kontabël. Banka nuk ka pasuri të klasifikuara në këtë kategori.

Pasuritë financiare me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (FVOCI)

Banka llogarit pasuritë financiare në FVOCI nëse aktivet plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Mbahen nën një model biznesi, objektivi i të cilit është "të mbledhë" flukset e parave të shoqëruara dhe të shesë dhe
- Kushtet kontraktuale të pasurive financiare që shkaktojnë flukse monetare që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesi mbi shumën kryesore të mbetur.

Çdo fitim ose humbje e njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (OCI) do të riciklohet pas ç'regjistrimit të pasurisë. Banka nuk ka pasuri të klasifikuara në këtë kategori.

c) Ç'regjistrimi

Banka ç'regjistron një pasuri financiare kur të drejtat kontraktuale mbi rrjedhat e parasë së asaj pasurie nuk janë më të vlefshme, ose kur transferon të drejtat për të marrë rrjedhat e parasë të pasurisë nëpërmjet një transaksioni, i cili transferon në mënyrë thelbësore të gjitha risqet dhe përfitimet nga pronësia mbi pasurinë financiare. Çdo interes mbi pasuritë e transferuara, i krijuar apo i mbajtur nga Banka njihet si pasuri apo detyrim i veçantë. Banka ç'regjistron detyrimet financiare nëse detyrimet e detajuara në kontratë përfundojnë, janë shlyer ose janë anuluar.

d) Netimi

Pasuritë dhe detyrimet financiare netohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Banka ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto, ose të realizojë pasurinë dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashmesi ato në aktivitetin tregtar të Bankës.

e) Matja e kostos së amortizuar

Kostoja e amortizuar e një pasurie ose detyrimi financiar, është vlera me të cilën pasuria ose detyrimi njihet në momentin fillestar, duke i zbritur pagesat e kryegjësë, plus/minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për dëmtim (për pasuritë financiare).

f) Matja e vlerës së drejtë

Vlera e drejtë është çmimi që do të merrej për të shitur një pasuri ose do të paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes në principal ose, në mungesë të tij, tregu më i favorshëm në të cilin Banka ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyron rrezikun e tij të mos-performancës.

Kur është në dispozicion, përcaktimi i vlerave të drejta të aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare bazohet në çmimet e kuotuar të tregut ose në kuotate çmimeve të tregtarëve për instrumentet financiare të tregtuara në tregjet aktive. Një treg vlerësohet aktiv, nëse çmimet e cituara janë në dispozicion të rregullt dhe rregullisht përfaqësojnë transaksione reale dhe të rregullta të tregut në bazë të gjatësisë së krahut.

Nëse një treg për një instrument financiar nuk është aktiv, Banka vendos vlerëne drejtë duke përdorur një teknikë vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknikat e vlerës aktuale të vlerës, metodëne zbritur të fluksit të parave, krahasimin me instrumente të ngjashme për të cilat ekzistojnë çmimet e vëzhguara të tregut, dhe modelet e vlerësimit. Për këto instrumente financiare, inputet në modele janë të vëzhguara nga tregu.

g) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë

Matja e humbjeve të pritura të kredisë sipas SNRF 9 përdor informacionin dhe qasjet që Banka përdor për të menaxhuar rrezikun e kredisë. Disa rregullime që lidhen me ndryshimin në biznes vitet e fundit janë bërë në mënyrë që të përputhen me kërkesat e SNRF 9. Humbjet e kredisë llogariten duke përdorur një model zhvlerësimi tre faza, bazuar në faktin nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë së aktivi financiar që nga njohja fillestare e tij.

Inputet kryesore për matjen e humbjeve të pritura të kredisë janë termi i strukturës së variablave të mëposhtëm:

- Gjasat për mospagesë (PD)
- Humbjet për shkak të mospagesës (LGD), and (Humbja) e ekspozuar në rast të mospagesës (EAD).

Gjasat për mospagesë ("PD") - paraqet një vlerësim të gjasave për mospagesë brenda një spektri të caktuar kohor (12 muaj ose gjatë jetëgjatësisë).

Humbja për shkak të mospagesës ("LGD") - paraqet një vlerësim të humbjes e cila paraqitet me rast të pagesës. Ajo bazohet në dallimin mes rrjedhës së kontraktuar të parasë së gatshme dhe asaj që huadhënësi pret të pranojë, duke përfshirë edhe ato ngaçfarëdo kolaterali. Zakonisht shprehet si përqindje e EAD-së (Humbjes së Ekspozuar me rastin e mospagesës).

Ekspozimi ndaj mospagesës ("EAD") - ky është një vlerësim i ekspozimit të mospagesës në një datë të paracaktuar, duke marrë parasysh ndryshimet e pritura në ekspozim pas datës së raportimit, duke përfshirë ripagimet e principalit dhe të interesit, dhe zbritjet e pritura në lehtësitë e zotuar.

Sidoqoftë, faktorët që duhet të merren parasysh kur përcaktohet nëse rreziku i kredisë është rritur në mënyrë të konsiderueshme për të gjitha kreditë dhe kështu përcaktimi për vendosjen e kredive janë renditur më poshtë:

- Klasifikimi i rrezikut të kredisë
- Prezumimi i kundërshtueshëm
- Treguesit e përgjithshëm të ndryshimeve të rrezikut të kredisë siç përcaktohet nga standardi
- Kërkimi paraprak i informacionit

Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogaritë lejimit kundrejt huave dhe paradhënieve. Interesi për aktivin e zhvlerësuar vazhdon të njihet përmes zhvlerësimit rënës. Kur një ngjarje pasuese bën që vlera e humbjeve të pritshme të ulet, ulja e humbjes nga zhvlerësimi kthehet përmes fitimit ose humbjes.

Zhvlerësimi i pasurive financiare (periudha krahasuese)

Në secilën datë raportimi, Banka vlerëson nëse ka prova objektive që aktivet financiare që nuk barten me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes janë zhvlerësuar. Pasuritë financiare janë zhvlerësuar kur provat objektive tregojnë se një ngjarje humbjeje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit, dhe se ngjarja e humbjes ka një ndikim në flukset e ardhshme të parave në aktiv, të cilat mund të vlerësohen me besueshmëri.

Banka i konsideron provat për huatë dhe paradhëniet e zhvlerësimit si në një aktiv të veçantë ashtu edhe në atë kolektiv. Të gjitha aktivet financiare të rëndësishme individuale vlerësohen për zhvlerësim specifik. Të gjitha aktivet domethënëse të konstatuara se nuk janë zhvlerësuar në mënyrë specifike, atëherë vlerësohen kolektivisht për çdo zhvlerësim që është bërë por nuk është identifikuar ende. Pasuritë që nuk janë individualisht të rëndësishme, vlerësohen kolektivisht për zhvlerësim duke grupuar aktivet financiare me karakteristika të ngjashme rreziku.

Provat objektive që aktivet financiare janë zhvlerësuar mund të përfshijnë mospagesë ose delikuencë nga një huamarrës, ristrukturimin e një kredie ose paradhënie nga Banka me kushte që Banka nuk do t'i konsideronte ndryshe, indikacione që një huamarrës do të hyjë në falimentim, ose të dhëna të tjera të vëzhgueshme në lidhje me një grup aktivesh siç janë ndryshimet e pafavorshme në statusin e pagesës së huamarrësve në grup, ose kushteve ekonomike që lidhen me paragrafët në grup.

Në vlerësimin e kompensimit të humbjes kolektive të huasë, Banka përdor modelimin statistikor të tendencave historike të probabilitetit të mospagimit, kohën e kthimeve dhe shumën e humbjeve të bëra. PAGESA SPECIFIKE E HUMBJES SË HUASË BAZOHET NË KOLATERALIN THEMELOR TË NJË KREDIE, PROVAT E FLUKSIT TË PARAVE PËR KTHIMIN E KREDISË, GJYKIMIN E MENAXHMENTIT PËR KUSHTET AKTUALE EKONOMIKE, VLERËN E KOLATERALIT THEMELOR, NËSE KA, DHE VLERËSIMIN E KREDISË SË PORTFOLIOS KREDITORE. Menaxhmenti beson se këto lejime janë adekuate për humbjet e kredisë të cilat janë të natyrshme në portfolion e kredisë.

Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve të bartura me koston e amortizuar maten si diferenca midis vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të fluksit të parave të vlerësuar të zbritura në normën fillestare të interesit efektiv të aktiveve.

Humbjet njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari të lejimit kundrejt huave. Interesi për aktivin e zhvlerësuar vazhdon të njihet përmes lëshimit të zbritjes. Kur një ngjarje pasuese bën që vlera e humbjes së zhvlerësimit të zvogëlohet, humbja nga zhvlerësimi kthehet përmes fitimit ose humbjes. Banka i shlyen kreditë e caktuara për klientët kur ato janë përcaktuar të pambledhshme.

Klasifikimi dhe matja e detyrimeve financiare

Detyrimet financiare të Bankës përfshijnë huazime nga bankat dhe institucionet e tjera financiare dhe detyrimet e tjera.

Detyrimet financiare fillimisht maten me vlerën e drejtë, dhe kur është e përshtatshme, rregullohen për kostot e transaksionit, përveç nëse Banka caktoi një detyrim financiar me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

Më pas, detyrimet financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, përveç për derivatet dhe detyrimet financiare të përcaktuara në FVTPL, të cilat barten më pas në vlerën e drejtë me fitime ose humbje të njohura në fitim ose humbje (përveç instrumenteve financiare derivative të përcaktuara dhe efektive si instrumente mbrojtëse). Të gjitha tarifat që lidhen me interesin dhe nëse është e aplikueshme, ndryshimet në vlerën e drejtë të një instrumenti që raportohen në fitim ose humbje, përfshihen në kostot e financimit ose të ardhurat nga financat.

3.7 Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë kartëmonedha dhe monedha në arkë dhe pasuri të tjera financiare afatshkurtra e likuide, me maturitet origjinal tre muaj ose më pak, të cilat kanë rrezik të pakonsiderueshëm ndryshimi të vlerës së tyre të drejtë dhe përdoren nga Banka për menaxhimin e zotimeve afatshkurtra. Paraja dhe ekuivalentet e saj mbahen me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

3.8 Pajisjet

(i) Njohja dhe matja

Zyrat dhe pajisjet maten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë. Kostoja përfshin shpenzimet që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e aktivitetit. Programi kompjuterik i blerë që është pjesë përbërëse e funksionalitetit të aktivitetit përkatës është kapitalizuar si pjesë e asaj pajisjeje.

Kostoja e pasurisë së vetë-krijuar përfshin koston e materialeve dhe të punës direkte, çdo kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për përdorimin e saj të synuar, si dhe kostot e çmontimit dhe heqjes së pjesëve dhe rivendosjen e lokacionit në gjendjen e mëparshme.

Kur pjesë të ndryshme të një pajisjeje kanë jetë të ndryshme të dobishme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta (përbërësit kryesorë) të pajisjeve. Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit të përcaktuara duke krahasuar të ardhurat me vlerën kontabël njihen në fitim ose humbje.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një pajisje njihet në vlerën e bartur të elementit nëse është e mundshme që përfitimet ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Bankë dhe kostoja e saj mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në humbje ose fitim në momentin kur ndodhin.

(iii) Rënia në vlerë

Në fund të çdo periudhe raportuese, menaxhmenti vlerëson nëse ka ndonjë tregues të rënies në vlerë të ndërtesave dhe pajisjeve. Nëse ekziston ndonjë tregues i tillë, menaxhmenti vlerëson shumën e rikuperueshme, e cila përcaktohet si vlerë e drejtë më e lartë e një aktivi minus kostot për shitje dhe vlera e saj në përdorim. Vlera kontabël është zvogëluar në shumën e rikuperueshme dhe humbja nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje për vitin. Një humbje nga zhvlerësimi e njohur për një aktiv në vitet e mëparshme kthehet mbrapsht, nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e aktivit në përdorim ose vlerën e drejtë minus kostot për shitje.

(iv) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi llogaritet duke përdorur metodën lineare për të alokuar kostote tyre për vlerat e tyre të mbetura mbi jetën e përdorimit të parashikuar:

Pajisjet e zyrës dhe të tjera	20%
Kompjuterat dhe pajisjet e IT	20%
Veturat	20%

E drejta e përdorimit të pasurisë dhe përmirësimet në qira janë zhvlerësuar gjatë afatit më të shkurtër të qirasë dhe jetës së tyre të dobishme. Të gjitha të drejtat e përdorimit të pasurisë kanë periudhë 5 vjeçare të maturimit.

Vlerat e mbetura të pasurive dhe jeta e përdorimit rishikohen dhe rregullohen nëse është e nevojshme, në fund të çdo periudhe të raportimit.

3.9 Pasuritë e paprekshme

(i) Njohja dhe matja

Pasuritë e paprekshme të blera nga Banka mbahen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

(ii) Kostot vijuese

Shpenzimet e mëvonshme mbi pasuritë e paprekshme kapitalizohen vetëm kur rriten përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në pasurinë specifike për të cilin lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen kur ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në fitim ose humbje në baza lineare përgjatë jetës së dobishme të asetit. Jeta e dobishme e pasurisë së paprekshme është 5 vjet.

3.10 Pasuritë e riposeduara

Pasuritë e riposeduara përfaqësojnë pasuritë jofinanciare të fituara nga Banka në ekzekutim të kredive të vonuara dhe që synon shitjen e tyre brenda një kohe sa më të shkurtër. Pasuritë njihen fillimisht me vlerën me të cilën fitohen si inventarë brenda pasurive të tjera dhe më pas maten me vlerën më të ulët mes koston dhe vlerës së realizueshme neto ndërsa çdo ulje e vlerës së tyre njihet si humbje.

3.11 Përfitimet e punonjësve

Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Kosovë sipas një plani të përcaktuar kontributësh. Detyrimet për kontributet në planet e pensioneve me kontribut të përcaktuar njihen si shpenzim në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

3.12 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të shkuara, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të matet në mënyre të besueshme, dhe ka shumë të ngjarë që për të shlyer detyrimin, të kërkohet një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike. Provizionet janë përcaktuar duke skontuar flukset e pritshme monetare me një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregut për vlerën në kohë të parase dhe, sipas rastit, rreziqet specifike të detyrimit.

3.13 Standardet e reja, interpretimet dhe amendamentet që nuk janë ende efektive për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2022

Ekzistojnë një sërë standardesh, ndryshimesh standardesh dhe interpretimesh që janë lëshuar nga BSNK, të cilat janë efektive në periudhat e ardhshme kontabël që Banka ka vendosur të mos i miratojë më herët.

Ndryshimet e mëposhtme janë në fuqi për periudhën që fillon më 1 janar 2023:

- SNRF 17 Kontratat e Sigurimit;
- Shpalosjet për politikat kontabël (Ndryshimet në SNK 1 dhe SNRF Deklarata e Praktikës 2);
- Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (Ndryshimet në SNK 8); dhe
- Tatimi i shtyrë në lidhje me pasuritë dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm (Ndryshimet në SNK 12).

Ndryshimet e mëposhtme janë në fuqi për periudhën që fillon më 1 janar 2024:

- SNRF 16 Qiratë (Amendamenti – Detyriminë një shitje dhe kthim me qira)
- SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare (Amendamenti – Klasifikimi i Detyrimeve si Afatshkurta ose Afatgjata)
- SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare (Amendamenti – Detyrimet afatgjata me Kushte)

Banka nuk pret që ndonjë standard i nxjerrë nga BSNK, e që nuk janë ende në fuqi, të ketë një ndikim material në pasqyrat financiare.

4. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

4.1 Hyrje dhe vështrim i përgjithshëm

Banka ka ekspozim ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- Rreziku i kredisë
- Rreziku i likuiditetit
- Rreziku i tregut

Ky shënim paraqet informacion në lidhje me ekspozimin e Bankës ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivat, politikat dhe proceset e Bankës për matjen dhe menaxhimin e rrezikut, si dhe menaxhimin e kapitalit të Bankës.

Korniza e menaxhimit të rrezikut

Bordi i Drejtorëve ka përgjegjësinë finale për krijimin dhe mbikëqyrjen e kornizës së menaxhimit të rrezikut të Bankës. Bordi dhe menaxhmenti kanë krijuar komitete të ndryshme të cilat janë përgjegjëse për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të rrezikut në tërësi .

Politikat e Bankës për menaxhimin e rrezikut janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballet Banka, për të vendosur kufijtë dhe kontrollet e duhura të rrezikut dhe për të monitoruar rreziqet dhe respektimin e limiteve.

Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara. Banka, nëpërmjet trajnimeve dhe procedurave dhe politikave të saj për menaxhmentin, synon të zhvillojë një mjedis konstruktiv kontrolli, në të cilintë gjithë punonjësit të kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

4.2 Rreziku kreditor

Rreziku kreditor është rreziku që nëse një klient ose pala tjetër e një instrumenti financiar nuk do të shlyejë detyrimin dhe do të shkaktojë që Banka të pësojë një humbje. Banka menaxhon rrezikun kreditor duke miratuar ekspozime të barabarta me 10% të kapitalit rregullator të bankave. Ekspozimi primar i Bankës ndaj rrezikut kreditor lind nëpërmjet kredive të saj për klientët. Përqendrimet e rrezikut kreditor (qoftë në bilanc ose jashtë bilancit) lindin nga pamundësia e klientëve për të përmbushur detyrimet kontraktuale të cilat mund të ndikohen nga mjedisi operativ ose ciklet e tyre të biznesit. Banka nuk ka ekspozim të rëndësishëm ndaj ndonjë klienti ose kundërpale individuale dhe zakonisht i jep hua jo më shumë se 1,500,000 euro për çdo klient të vetëm. Banka gjithashtu ka ekspozim ndaj bankave në formën e llogarive bankare dhe depozitave. Rreziku i kredisë lidhur me bankat menaxhohet përmes alokimit të fondeve në dispozicion në bankat e ndryshme që operojnë në Kosovë.

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut kreditor përfaqësohet nga vlera kontabël e çdo pasurie financiare në pasqyrën e pozicionit financiar.

Menaxhimi i rrezikut kreditor

Bordi i Drejtorëve ia ka deleguar përgjegjësinë për menaxhimin e rrezikut kreditor në Komitetin e Kredive. Departamentit të kredisë i kërkohet të zbatojë politikat dhe procedurat e kreditimit dhe është përgjegjës për cilësinë dhe performancën e portfolios kreditorë si dhe për monitorimin dhe kontrollin e të gjitha rreziqeve të kredisë në portfolion e tij. Politika e Bankës është që të kërkojë kolateral të përshtatshëm që të sigurohet nga klientët përpara disbursimit të kredive të miratuara. Kolaterali për kredi zakonisht merret në formën e automjeteve/pajisjeve dhe mallrave, ose hipoteka.

Kredi të zhvlerësuar

Kreditë e zhvlerësuar janë kredi për të cilat Banka përcakton se është e mundshme të mos jetë në gjendje të mbledhë të gjithë principalin dhe interesin e duhur sipas kushteve kontraktuale të huasë. Këto kredi janë klasifikuar A+,A,A-,B+,B,B-,C+,C,C-,D+,D,D- në sistemin e brendshëm të klasifikimit të rrezikut kreditor të Bankës.

Bazuar në politikën e brendshme të vlerësimit të Bankës, vlerësimi i portfolios më 31 dhjetor 2022 është si më poshtë:

Vlerësimi i kredisë së Bankës	31 Dhjetor 2022	% ndaj Totalit Bruto
A+	-	0%
A	-	0%
A-	300,053	3.76%
B+	618,758	7.75%
B	1,219,141	15.27%
B-	1,507,676	18.88%
C+	-	0%
C	1,378,243	17.26%
C-	500,114	6.26%
D+	-	0%
D	-	0%
D-	-	0%
Kreditë me vlerësim kreditor	5,523,985	69.17%
Kreditë pa vlerësim	2,461,982	30.83%
Totali i portfolios bruto të kredisë	7,985,967	100.00%

Tabela e mëposhtme tregon cilësinë e kredisë sipas kategorive të pasurisë për kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve ndaj rrezikut të kredisë, bazuar në sistemin e brendshëm të vlerësimit të kredisë të Bankës. Shumat e paraqitura janë vlera kontabël bruto. Bazuar në Regjistrin e Kredive të Bankës Qendrore të Kosovës, klasifikimi i portfolios më 31 dhjetor 2022 është si vijon:

Klasifikimi kreditor i BQK-së	31 Dhjetor 2022	% ndaj totalit bruto
A	7,985,967	100%
B	-	0%
C	-	0%
D	-	0%
E	-	0%
Kreditë me vlerësim kreditor	7,985,967	100%
Kreditë pa vlerësim	-	0%
Totali i portfolios bruto të kredisë	7,985,967	100%

Më 31 dhjetor 2022, Banka nuk ka ekspozime të vonuara dhe të pazhvlerësuara për kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve.

Kredi me kushte të rinegociuara

Kreditë me kushte të rinegociuara janë kreditë që janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të gjendjes financiare të huamarrësit dhe ku Banka ka bërë lëshime që në të kundërt nuk do t'i merrte në konsideratë. Pasi kredia të ristrukturohet, ajo mbetet në këtë kategori e pavarësisht nga performanca e kënaqshme pas ristrukturimit derisa të plotësohen kërkesat në lidhje me kriteret e daljes nga kjo kategori sipas rregullores në fuqi.

Lejimet për dëmtimet

Banka krijon një provizion për humbjet nga dëmtimet që përfaqëson vlerësimin e saj të humbjeve të shkaktuara në portfolion e saj të kredisë. Komponentët kryesorë të këtij provizioni janë një komponent specifik i humbjes që lidhet me ekspozimet individuale të rëndësishme dhe një provizion kolektiv i humbjes së kredisë i krijuar për grupe aktivesh homogjene në lidhje me humbjet që janë shkaktuar, por që nuk janë identifikuar në kreditë që i nënshtrohen vlerësimit individual për dëmtim.

Politika e shlyerjes

Banka shlyen një kredi (dhe çdo provizion të lidhur për humbjet nga dëmtimi) kur menaxhmenti përcakton se kredia është e paarkëtueshme. Ky përfundim arrihet pas shqyrtimit të informacionit të tillë si ndodhja e ndryshimeve të rëndësishme në pozicionin financiar të huamarrësit, të tilla që huamarrësi nuk mund të paguajë më detyrimin, ose që të ardhurat nga kolaterali nuk do të jenë të mjaftueshme për të shlyertë gjithë ekspozimin. Banka gjithashtu mund të shlyejë një kredi në bazë të një vendimi të Bordit kur të gjitha masat e tjera të marra për mbledhjen e kredisë kanë qenë të pasuksesshme.

Ndryshimet në vlerën kontabël bruto të kredive për klientët me kosto të amortizuar:

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Total
Bilanci fillestar 31 Dhjetor 2021	-	-	-	-
Transferimi në Fazën 1 (prej 2 ose 3)	-	-	-	-
Transferimi në Fazën 2 (prej 1 ose 3)	-	-	-	-
Transferimi në Fazën 3 (prej 1 ose 2)	-	-	-	-
Mjetet financiare me origjinë	7,985,967	-	-	7,985,967
Çregjistrimi i mjeteve financiare	-	-	-	-
Fshirjet	-	-	-	-
Ndryshimet për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në mosnjohje	-	-	-	-
Këmbimi valutor dhe ndryshime të tjera	-	-	-	-
Bilanci përfundimtar 31 Dhjetor 2022	7,985,967	-	-	7,985,967

Ndryshimet në shumën HPK (Humbjet e Pritshme Kreditore) për klientët me kosto të amortizuar:

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Total
Bilanci fillestar 31 Dhjetor 2021	-	-	-	-
Transferimi në Fazën 1 (prej 2 ose 3)	-	-	-	-
Transferimi në Fazën 2 (prej 1 ose 3)	-	-	-	-
Transferimi në Fazën 3 (prej 1 ose 2)	-	-	-	-
Mjetet financiare me origjinë	36,487	-	-	36,487
Çregjistrimi i mjeteve financiare	-	-	-	-
Fshirjet	-	-	-	-
Ndryshimet për shkak të modifikimeve që nuk rezultojnë në mosnjohje	-	-	-	-
Këmbimi valutor dhe ndryshime të tjera	-	-	-	-
Bilanci përfundimtar 31 Dhjetor 2022	36,487	-	-	36,487

Ekspozimi ndaj rrezikut kreditor

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë - Instrumentet financiare që i nënshtrohen zhvlerësimit

Tabela në vijim përmban një analizë të ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë të instrumenteve financiare për të cilat njihet një ndihmë e HPK've. Vlera kontabël bruto e pasurive financiare më poshtë paraqet gjithashtu ekspozimin maksimal të Bankës ndaj rrezikut të kredisë për këto pasuri para kolateralit dhe përmirësimeve të tjera të kredisë.

Kolaterali

Banka mban kolateral kundrejt huave për klientët në formën e hipotekave, automjeteve e pajisjeve. Vlerësimet e vlerës së drejtë bazohen në vlerën e kolateralit të vlerësuar në kohën e huamarrjes. Mbulimi i kolateralit llogaritet kur kredia është disbursuar dhe kërkohet së paku 100% e shumës së kredisë së disbursuar.

Më 31 Dhjetor 2022	Mbi-kolateralizuar		Nën-kolateralizuar	
	Vlera kontabël e pasurive	Vlera nominale e kolateralit	Vlera kontabël e pasurive	Vlera nominale e kolateralit
Biznes	3,552,509	11,783,449	2,283,344	477,623
Individë	404,063	560,440	1,746,050	400,019
Total bruto portfolio e kredive	3,956,572	12,343,889	4,029,394	877,642

Përqendrimi i rrezikut të kredisë

Banka monitoron përqendrimet e rrezikut kreditor sipas segmentimit dhe vendndodhjes gjeografike. Analiza e përqendrimit të rrezikut kreditor për kreditë dhe paradhëniet për klientët bruto në datën e raportimit është paraqitur më poshtë.

Përqendrimi sipas segmentit (bruto):	Më 31 Dhjetor 2022
Ndërmarrjet e mesme	244,809
Ndërmarrjet e vogla	2,533,401
Individë	5,207,757
Gjithsej	7,985,967

Kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve (bruto)	Më 31 Dhjetor 2022		
	Kosovë	Tjera	Gjithsej
Tregti me shumicë dhe pakicë	3,212,859	-	3,212,859
Familjare	2,303,918	-	2,303,918
Ndërtimi	998,338	-	998,338
Prodhimtaria	924,894	-	924,894
Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	242,290	-	242,290
Aktivitete të tjera shërbimi	198,611	-	198,611
Veprimtaritë e shërbimeve administrative dhe mbështetëse	50,022	-	50,022
Arte, argëtim dhe rekreacion	30,030	-	30,030
Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi	25,005	-	25,005
Gjithsej	7,985,967	-	7,985,967

4.3 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Banka do ballafaqohet me vështirësi në përmbushjen e detyrimeve financiare.

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Banka të hasë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve afatshkurtra nga detyrimet e saj financiare. Banka financohet nga depozitat pa afat dhe është e ekspozuar ndaj tërheqjeve ditore nga depozitat në llogaritë rrjedhëse dhe ato të kursimeve. Rreziku i likuiditetit menaxhohet nga Menaxhmenti i Bankës. Qasja e Bankës për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit është të sigurojë që, për aq sa është e mundur, të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e saj kur është e nevojshme, në rrethana normale dhe nën presion, pa pësuar humbje të paarsyeshme ose dëmtuar reputacionin e Bankës.

Kërkesa rregullative e rezervës së detyrueshme të mbajtur në Bankën Qendrore llogaritet si 10 për qind e detyrimeve mesatare që duhet të paguhen brenda një viti. Pasuria me të cilat banka mund të plotësojë kërkesat e saj për rezervë janë depozitat e saj në BQK dhe pesëdhjetë për qind (50%) e parave të gatshme në kasafortën e saj. Më 31 dhjetor 2022, teprica e rezervës së likuiditetit është 650,874 EUR.

Tabela e mëposhtme tregon vlerat kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve më 31 Dhjetor 2022 sipas maturimit të mbetur kontraktual të tyre.

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit

Banka vlerëson vazhdimisht rrezikun e likuiditetit duke identifikuar dhe monitoruar ndryshimet në financimin e kërkuar për të përmbushur objektivat e biznesit çdo objektivi të vendosur në drejtim të strategjisë së përgjithshme të Bankës. Të gjitha pasuritë dhe detyrimet financiare raportohen në bazë të kohës kur detyrimet bëhen të arritura dhe pasuritë mund të përdoren si burim për shlyerje. Banka i klasifikon llogaritë rrjedhëse si detyrime sipas kërkesës 25% të gjendjes deri në 1 muaj, ndërsa 75% e gjendjes konsiderohet si kërkesë nga 1 deri në 3 muaj. Më poshtë janë maturimet e mbetura ndërmjet pasurive dhe detyrimeve financiare kontraktuale dhe të pritshme në datën e raportimit.

Më 31 Dhjetor 2022	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 12 muaj	6 deri në 12 muaj	Mbi 1 vit	Gjithsej
Pasuritë						
Paraja në dorë dhe në bankë	1,256,717	-	-	-	-	1,256,717
Bilanci në BQK	11,146,429	-	-	-	-	11,146,429
Kredi për klientët	77,673	322,600	456,186	930,643	6,745,316	8,532,418
Total	12,480,819	322,600	456,186	930,643	6,745,316	20,935,564
Detyrimet						
Detyrimet ndaj klientëve	2,010,012	6,099,011	-	3,687,417	335,038	12,131,478
Detyrimet tjera	274,441	-	-	-	-	274,441
Total	2,284,453	6,099,011	-	3,687,417	335,038	12,405,919
Hendeku	10,196,366	(5,776,411)	456,186	(2,756,774)	6,410,278	8,529,645
Hendeku kumulativ	10,196,366	4,419,955	4,876,141	2,119,367	8,529,645	-

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimet në çmimet e tregut, të tilla si normat e interesit, normat e këmbimit valutor dhe diferencat e kredisë, do të ndikojnë në të ardhurat e Bankës ose në vlerën e zotërimeve të saj të instrumenteve financiare. Objektivi i menaxhimit të rrezikut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin e rrezikut.

ALCO është përgjegjëse për menaxhimin e përgjithshëm të rreziqeve të tregut. Rreziku i pozicioneve valutore matet dhe raportohet nga Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut në baza ditore. Banka e menaxhon këtë rrezik duke mbyllur pozicionet e hapura ditore në valutë dhe duke vendosur e monitoruar kufizime për pozicionet e hapura. Banka administron rrezikun e normës së interesit duke kryer analizën e hendekut të rivlerësimit dhe analizën e margjinës së fitimit për secilën monedhë kryesore. Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut i përgatit këto raporte në baza mujore.

Ekspozimi ndaj rrezikut të valutës së huaj

Rreziku i valutës së huaj është rreziku që vlera e instrumenteve financiare do të luhetet për shkak të ndryshimeve në kurset e këmbimit valutor. Banka nuk ka ekspozim ndaj rrezikut të këmbimit valutor. Banka nuk ka pasuri dhe as detyrime në valutë të huaj.

Ekspozimi ndaj rreziku të normës së interesit

R i normës së interesit është rreziku që vlera e instrumenteve financiare do të luhatet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut. Banka menaxhon rrezikun e normës së interesit duke monitoruar kushtet e tregut dhe duke marrë vendime të përshtatshme për çmimet ose rialokimin. Të gjitha kreditë janë me norma fikse dhe kanë afat maturimi nga një muaj deri në pesë vjet.

Profili i normës së interesit të instrumenteve financiare me interes të Bankës është si më poshtë:

Hendeku i ndjeshmërisë ndaj interesit	Deri në 1 muaj	1 - 6 muaj	6-12 muaj	1 - 2 vjet	2-5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Total i ndjeshëm ndaj interesit	Total jo i ndjeshëm ndaj interesit
Pasuritë								
Paratë e gatshme dhe depozitat në bankë qendrore	12,164,941	-	-	-	-	-	-	12,164,941
Depozitat në banka	238,012	-	-	-	-	-	-	238,012
Kredi dhe paradhënie për klientët (fikse)	77,673	778,786	930,643	1,829,893	3,383,591	1,531,832	8,532,418	-
Pasuri të tjera	759,285	-	-	-	-	-	-	759,285
Gjithsej pasuritë	13,239,911	778,786	930,643	1,829,893	3,383,591	1,531,832	8,532,418	13,162,238
Detyrimet								
Llogaritë rrjedhëse nga klientët	2,340,012	7,088,989	-	-	-	-	-	9,429,001
Depozita me afat (fikse)	-	-	3,685,000	-	335,041	-	4,020,041	-
Detyrime të tjera	343,822	-	-	-	-	-	-	343,822
Gjithsej detyrimet	2,683,834	7,088,989	3,685,000	-	335,041	-	4,020,041	9,772,823
Hendeku i ndjeshmërisë IR	10,556,077	(6,310,203)	(2,754,357)	1,829,893	3,048,550	1,531,832	4,512,376	3,389,415

Banka nuk kontabilizon asnjë pasuri financiar me normë fikse ose detyrim financiar me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, dhe Banka nuk përdor derivativë (swap-e të normave të interesit) si instrumente mbrojtëse. Prandaj, një ndryshim në normat e interesit në datën e raportimit nuk do të ndikonte në fitimin ose humbjen për instrumentet me normë fikse.

5. PËRCAKTIMI I VLERËS SË DREJTË

Aty ku është e mundur, vlera e drejtë e kredive bazohet në transaksionet e vëzhgueshme të tregut. Kur transaksionet e vëzhgueshme të tregut nuk janë të disponueshme, vlera e drejtë vlerësohet duke përdorur modele vlerësimi, të tilla si teknikat e skontuara të fluksit monetar. Inputi në teknikat e vlerësimit përfshin humbjet e pritshme të kredisë gjatë gjithë jetës dhe normat e interesit. Kreditë e vogla homogjene grupohen në portfol me karakteristika të ngjashme.

Aktivitet financiarë të bartura me kosto të amortizuar

Vlera e drejtë e vlerësuar e parasë dhe ekuivalentëve të saj, të cilat përfshijnë depozitat pa maturim të deklaruar, është shuma e ripagueshme sipas kërkesës. Për depozitat afatshkurtra, vlera e drejtë e tyre konsiderohet të jetë e përafërt me vlerën e tyre kontabël. Kreditë për klientët janë neto nga provizionet për zhvlerësim.

Portfolio kreditore ka një vlerë të drejtë të vlerësuar afërsisht të barabartë me vlerën e saj kontabël për shkak të natyrës së tyre afatshkurtra ose normave bazë të interesit, të cilat përafrojnë normat e tregut. Vlera e drejtë e huave është vlerësuar duke përdorur teknikat e skontuara të fluksit monetar, duke zbatuar normat që ofrohen për huatë me kushte të ngjashme.

Detyrimet financiarë të bartura me kosto të amortizuar

Për shkak se nuk ekziston treg aktiv për huamarrjet dhe borxhin e varur, vlera e drejtë është vlerësuar duke përdorur një model skontimi të flukseve të mjeteve monetare bazuar në një lakore tanishme të të ardhurave të përshtatshëm për periudhën e mbetur deri në maturim.

Tabela e mëposhtme paraqet vlerat e drejta të instrumenteve financiare që nuk maten me vlerën e drejtë dhe i analizon ato sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë në të cilën kategorizohet çdo matje e vlerës së drejtë.

Më 31 Dhjetor 2022	Kategoria	Vlera mbajtëse	Vlera e drejtë	Hierarkia e vlerës së drejtë
<i>Pasuritë financiare</i>				
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	Kosto e amortizuar	12,402,953	12,402,953	Niveli 1
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	Kosto e amortizuar	7,921,067	7,921,067	Niveli 3
Total		20,324,020	20,324,020	
<i>Detyrimet financiare</i>				
Depozita nga klientët	Kosto e amortizuar	12,131,478	12,131,478	Niveli 3
Detyrimet e qirasë	Kosto e amortizuar	248,951	248,951	Niveli 3
Detyrimet tjera	Kosto e amortizuar	274,441	274,441	Niveli 3
Total		12,654,870	12,654,870	

Vlera e drejtë e depozitave nga bankat dhe klientët është vlerësuar duke përdorur teknikat e skontimit të fluksit monetar, duke aplikuar normat që ofrohen për depozitat me maturitete dhe afate të ngjashme. Vlera e drejtë e depozitave të pagueshme sipas kërkesës është shuma e pagueshmenë datën e raportimit.

Banka filloi operimin në tremujorin e fundit të vitit të përfunduar në 31 dhjetor 2022. Pjesa më e madhe e kredive dhe depozitave të saj janë emetuar/kontraktuar afër fundit të vitit. Nuk pati luhatje të rëndësishme të normave të interesit gjatë kësaj periudhe të shkurtër dhe për këtë arsye vlera e drejtë e huave dhe paradhënieve për klientët dhe depozitave me afat përafrohet me vlerën e tyre kontabël.

6. PËRDORIMI I VLERËSIMIT DHE GJYKIMIT PROFESIONAL

Supozimet kryesore lidhur me të ardhmen, dhe burimet e tjera kryesore të pasigurisë së vlerësimit në datën e raportimit, që kanë një rrezik të konsiderueshëm për të shkaktuar një ndryshim material të vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit financiar të ardhshëm, diskutohen më poshtë. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme dhe bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë, përfshirë pritshmëritë mbi ngjarjet e ardhme të cilat mendohen të jenë të arsyeshme sipas rrethanave.

Informacioni mbi supozimet dhe pasiguritë e vlerësimit që kanë një rrezik të konsiderueshëm për të rezultuar në një rregullim material të vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit që përfundon më 31 dhjetor 2022 është përfshirë në shënimet e mëposhtme.

(i) Provizionet për humbjet nga zhvlerësimi i huave dhe paradhënieve

Banka rishikon portfolion e saj të kredisë për të vlerësuar dëmtimin në baza të rregullta. Në përcaktimin nëse duhet të regjistrohët një humbje nga zhvlerësimi, Banka bën gjykime nëse ka ndonjë të dhënë të vëzhgueshme që tregon se ka një rënie të matshme në flukset e ardhshme të parave të vlerësuar nga një portfolio kredish përpara se rënia të identifikohet me një kredi individuale në atë portfolio. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna të vëzhgueshme që tregojnë se ka pasur një ndryshim të pafavorshëm në statusin e pagesës së huamarrësve në një grup, ose në kushtet ekonomike kombëtare ose lokale që lidhen me mospagesat e pasurive në grup.

Menaxhmenti përdor vlerësime të bazuara në përvojën historike të humbjes për pasuritë me karakteristika të ngjajshme të rrezikut kreditore dhe evidencë objektive të dëmtimit me ato të portfolios kur planifikon flukset monetare të ardhshme. Metodologjia dhe supozimet e përdorura për vlerësimin e shumës dhe kohës së flukseve monetare të ardhshme rishikohen rregullisht për të reduktuar çdo ndryshim midis vlerësimeve të humbjeve dhe përvojës aktuale të humbjes.

(ii) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Një sërë politikash dhe shpalosjesh kontabël të Bankës kërkojnë matjen e vlerave të drejta për pasuritë dhe detyrimet financiare. Në matjen e vlerës së drejtë të një pasurie apo detyrimi, Banka përdor të dhëna të vëzhgueshme të tregut sa më shumë që të jetë e mundur. Vlerat e drejta kategorizohen në nivele të ndryshme në një hierarki të vlerës së drejtë bazuar në inputet e përdorura në teknikat e vlerësimit si më poshtë.

Niveli 1: Çmimet e kuotuar (të parregulluara) në tregjet aktive për pasuri ose detyrime identike që banka mund të ketë qasje në datën e matjes.

Niveli 2: Përveç çmimeve të kuotuar të përfshira në Nivelin 1, të cilat janë të vëzhgueshme për pasurinë ose detyrimin drejtpërdrejt ose tërthorazi.

Niveli 3: Të dhëna të pavëzhgueshme për pasurinë ose detyrimin (të dhëna të pavëzhgueshme).

Nëse të dhënat e përdorura për të matur vlerën e drejtë të një aktivi ose pasivi bien në nivele të ndryshme të hierarkisë së vlerës së drejtë, atëherë matja e vlerës së drejtë kategorizohet tërësisht në të njëjtin nivel të hierarkisë së vlerës së drejtë si inputet e nivelit më të ulët që është relevante për të gjithë matjen.

Banka njuh transferime ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë në fund të periudhës raportuese gjatësë cilës ka ndodhur ndryshimi.

7. PARAJA DHE EKVIVALENTËT E PARASË

	Më 31 Dhjetor 2022 (në EUR)
Para në arkë	1,018,512
Para në bankë	238,205
Bilanci BQK	11,146,429
Total	12,403,146
Zvogëluar: Lejim i humbjes	(193)
Gjithsej	12,402,953

Lëvizja e zhvleresimit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022, e ngarkuar në fitim dhe humbje është si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2022 (në EUR)
Gjendja hapëse me 1 janar	-
Pasuritë e reja financiare të krijuara	-
Lirimi për shkak të mosnjohjes	-
Rritje/ulje e dëmtimit	193
Bilanci përfundimtar	193

Në përputhje me rregulloren e BQK-së për rezervën minimale të detyrueshme, banka duhet të mbajë raportin e rezervës së detyruar minimale prej 10% të detyrimeve në vijim me maturim deri në një vit: depozitat, huazimet dhe letrat me vlerë. Asetet me të cilat banka mund të plotësojë kërkesën e saj për rezerva janë depozitate saj në BQK dhe 50% e parave të gatshme në kasafortë. Megjithatë, depozitat në BQK nuk mund të jenë më pak se gjysma e rezervës minimale të aplikueshme.

8. KREDI DHE PARADHËNIE PËR KLIENTË

	Më 31 Dhjetor 2022 (në EUR)
Kredi bruto për klientët	7,985,967
Interesi I përlogaritur	13,849
Tarifa e shtyrë	(42,342)
Gjithsej	7,957,474
Zvogëluar: Lejim i humbjes	(36,407)
Gjithsej	7,921,067

Lëvizjet në provizionet për zhvlerësimin e huave për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2022, e ngarkuar në fitim dhe humbje është si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2022 (në EUR)
Gjendja hapëse me 1 janar	-
Ngarkesa neto e dëmtimit	36,407
Pagesa nga kreditë e shlyera	-
Kreditë e shlyera	-
Bilanci përfundimtar	36,407

9. PASURITË E PAPERKSHME

	Softuer (në EUR)
Kosto Historike:	
1 Janar 2022	-
Shtesat gjatë vitit	208,094
31 Dhjetor 2022	208,094
Zhvlerësimi i Akumuluar:	
1 Janar 2022	-
Amortizimi për vitin	3,344
31 Dhjetor 2022	3,344
Vlera neto:	
Më 31 Dhjetor 2022	204,750

10. PRONA DHE PAJISJET

Kosto Historike	Automjete (në EUR)	Mobilet dhe pajisje (në EUR)	Pajisje kompjuterike dhe elektronike (në EUR)	Përmirësimet e qirasë (në EUR)	Gjithsej (në EUR)
1 Janar 2022					
Shtesat gjatë vitit	65,500	127,540	319,610	112,325	624,975
31 Dhjetor 2022	65,500	127,540	319,610	112,325	624,975
Zhvlerësimi i Akumuluar:					
1 Janar 2020					
Zhvlerësimi i vitit	3,267	3,798	4,970	3,744	15,779
31 Dhjetor 2022	3,267	3,798	4,970	3,744	15,779
Vlera neto:					
31 Dhjetor 2022	62,233	123,742	314,640	108,581	609,196

11. E DREJTA E PËRDORIMIT TË PASURISË

	Më 31 Dhjetor 2022 (në EUR)
1 Janar	
Shtesat	283,795
Gjithsej	283,795
Zhvlerësimi i akumuluar	
1 Janar	
Zhvlerësimi i vitit	35,956
Më 31 Dhjetor	35,956
Gjithsej vlera neto	247,839

12. PASURITË TJERA

	Më 31 Dhjetor 2022 (në EUR)
Shpenzimet e parapaguara	24,117
Pasuria tatimore e shtyrë	55,168
E arkëtueshme nga aksionari	680,000
Gjithsej	759,285

Pasuria tatimore e shtyrë është njohur në lidhje me të gjitha humbjet tatimore dhe diferencat e tjera të përkohshme që shkaktojnë pasuri tatimore të shtyra, ku drejtorët besojnë se ka të ngjarë që këto aktivetë rikuperohen. Banka operoi me një humbje të tatueshme në vlerën 564,947 euro gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2022. Këto humbje mund të barten deri në 4 vjet. Drejtorët besojnë se ka të ngjarë që pasuritë tatimore të shtyra të rikuperohen.

Të arkëtueshmet nga aksionari janë të lidhura me rritjen e kapitalit aksionar. Shuma është pranuar më 4 janar 2023.

13. DETYRIMET NDAJ KLINETËVE

	Më 31 Dhjetor 2022 (në EUR)
Llogaritë rrjedhëse	8,040,048
Llogaritë kursimi	68,972
Afatizimet	4,020,000
Interesi aktual	2,458
Gjithsej	12,131,478

14. DETYRIMET PËR QIRA

	Më 31 Dhjetor 2022 (në EUR)
Më 1 janar 2022	
Shtesat	283,445
Shpenzimet e interesit	3,684
Pagesat e qirasë	(38,178)
Më 31 Dhjetor 2022	248,951
Detyrimi i qirasë afatshkurtër	54,623
Detyrimi i qirasë afatgjatë	194,328

Banka merr prona me qira mbi të cilat qiraja periodike fiksohet gjatë afatit të qirasë. Banka ka marrë me qira 3 prona me një afat qiraje prej 5 vitesh që nga fillimi. Norma rritëse e huamarrjes në fillimin e qirasë e përdorur për matjen e detyrimeve të qirasë është 2.52%.

15. DETYRIMET TJERA

	Më 31 Dhjetor 2022 (në EUR)
Të pagueshme ndaj furnitorëve	223,876
Shpenzimet e përllogaritur	38,000
Kontributi pensional i pagueshëm në Fondin Pensional të Kosovës	5,074
Mbajtja e tatimit në burim për pagat e punonjësve	3,840
Të pagueshme të tjera	3,650
Gjithsej	274,440

16. KAPITALI AKSIONAR

Kapitali aksionar fillimisht ishte paguar plotësisht në vlerë prej 8,000,000 Euro. Me mbledhjen e aksionarëve të mbajtur më 5 dhjetor 2022 kapitali aksionar është rritur në 10,000,000 Euro. Në datën 31 dhjetor 2022, kapitali aksionar është paguar plotësisht nga Model Slovenia Shpk dhe Prisig SHA kompania e sigurimit. Pagesa e pjesës së mbetur të kapitalit aksionar në vlerë prej 680,000 Euro mbeti e papaguar nga Model Slovenia Invest Shpk më 31 dhjetor 2022 dhe e paraqitur në pasuritë tjera (shih shënimin 12). Kapitali aksionar i papaguar është paguar më 4 janar 2023.

Nr	Aksionari	Numri i aksioneve	Vlera nominale	EUR	%
1	Model Slovenia Invest ShPK	340	10,000	3,400,000	34%
2	Model Slovenia ShPK	330	10,000	3,300,000	33%
3	Prisig SHA kompani e sigurimit	330	10,000	3,300,000	33%
	Gjithsej	1,000	10,000	10,000,000	100%

17. TË ARDHURAT NGA INTERESI

	Periudha nga 14 Janari 2022 deri më 31 Dhjetor 2022 (në EUR)
Kreditë dhe paradhëniet ndaj klientëve	20,128
Lizing	143
Gjithsej	20,271

Të ardhurat nga interesi njihen në pasqyrën e fitimit dhe humbjes duke përdorur normën efektive të interesit.

18. SHPENZIMET E INTERESIT

	Periudha nga 14 Janari 2022 deri më 31 Dhjetor 2022 (në EUR)
Detyrimet ndaj klientëve	2,479
Interesi ndaj detyrimit të qirasë	3,684
Gjithsej	6,163

19. TË ARDHURA NGA TARIFAT DHE KOMISIONET, NETO

	Periudha nga 14 Janari 2022 deri më 31 Dhjetor 2022 (në EUR)
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet	
Shërbimet e pagesave	1,602
Tarifa të tjera	347
Gjithsej të ardhurat nga tarifat dhe komisionet	1,949
Shpenzimet nga tarifat dhe komisionet	
Tarifa e mirëmbajtjes së transaksionit dhe llogarisë	(3,267)
Gjithsej Shpenzimet të tarifave dhe komisioneve	(3,267)
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet, neto	(1,318)

20. SHPENZIMET E PERSONELIT

	Periudha nga 14 Janari 2022 deri më 31 Dhjetor 2022 (në EUR)
Pagat	309,129
Kontributet pensionale	15,698
Sigurim shëndetsor	4,825
Total	329,652

21. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE

	Periudha nga 14 Janari 2022 deri më 31 Dhjetor 2022 (në EUR)
Licencat dhe tarifat	63,818
Zhvlerësimi dhe amortizimi	55,078
Shërbimi profesional	18,764
Furnizimet për zyre	15,538
Sigurimi fizik	15,457
Shpenzimet e reklamimit dhe marketingut	5,506
Sigurimi	5,267
Pajisje të vogla	4,375
Shpenzimet e flotës së makinave	4,020
Komunikimet	3,485
Shërbimet komunale	3,188
Shpenzimet e pastrimit	2,894
Riparime dhe mirëmbajtje	1,889
Karburant për gjenerator	450
Shpenzime të tjera	11,756
Gjithsej	211,485

22. TATIMI NË TË ARDHURA

	Periudha nga 14 Janari 2022 deri më 31 Dhjetor 2022 (në EUR)
Shpenzimi aktual tatimor	-
Të ardhura/shpenzime tatimore të shtyra	55,168
Shpenzimi i tatimit mbi të ardhurat	55,168

Tatimi aktual mbi të ardhurat llogaritet në bazë të ligjitnr. 06/L-105 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave të Kosovës. Tatimi mbi të ardhurat e korporatave është 10% (2021: 10%).

23. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Palët e lidhura përfshijnë aksionerët e Bankës dhe menaxhmentin kyç. Deri më 31 dhjetor 2022, nuk ka kredi dhe paradhënie të lëshuara për palët e lidhura me bankën.

Kompensimi total për personelin menaxhues kyç të Bankës është si më poshtë:

Detyrimet	2022
Detyrimet ndaj klientëve (Aksionaret)	5,197,500
Detyrimet ndaj klientëve (Menaxhmenti)	13,872
Gjithsej	5,211,372
Shpenzimet	2022
Kompensimet e Menaxhmentit kyç	156,210
Kompensimet e Bordit	9,555
Gjithsej	165,765

24. ZOTIMET DHE KONTIGJENCAT

(i) Kontestet gjyqësore

Në rrjedhën normale të biznesit, Banka paraqitet me pretendime dhe procese gjyqësore. Banka aktualisht nuk ka ngjarje ligjore që ndikojnë në rrjedhën normale të biznesit.

(ii) Detyrimet tatimore

Pasqyrat financiare dhe të dhënat kontabël të Bankës nuk janë audituar nga autoritet tatimore që nga fillimi i operimit. Prandaj, detyrimet tatimore të Bankës mund të mos konsiderohen të përfunduara. Një parashikim për taksat dhe gjobat shtesë, nëse ka, që mund të vendosen, nuk mund të përcaktohet me ndonjë saktësi të arsyeshme në këtë fazë.

25. NGJARJET PAS DATËS RAPORTUESE

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit që mund të kërkojë rregullim ose informacione shpjeguese shtesë në pasqyrat financiare.

